

Tetor 2025

Buletin Informues

Linja e Parë Vendore për Prodhimin e Kornizave për Koshere Bletësh

Modernizimi i Bletarisë në Kosovë

Bletaria në Kosovë po evoluon dhe një biznes lokal po udhëheq këtë proces. Biznesi individual **Genc Caka**, me seli në **Komoran, Drenas**, ka bërë një hap të madh përpara në modernizimin e sektorit, me mbështetjen e **projektit SUNREED** të CNVP-së, i financuar nga **Ambasada e Suedisë në Prishtinë (Sida)**.

Ajo që filloi si një iniciativë modeste bletarie me vetëm pesë koshere në vitin 2012, është shndërruar në një nga ndërmarrjet më inovative të Kosovës në këtë sektor. I themeluar zyrtarisht në vitin 2017, Genc Cakaj ka zhvilluar vazhdimisht ekspertizën e tij në prodhimin e pajisjeve të bletarisë, veçanërisht koshere bletësh të përshtatura për nevojat lokale.

Që nga gushti i vitit 2025, me instalimin e pajisjeve moderne të përpunimit të drurit, kompania ka lansuar linjën e parë të prodhimit në Kosovë për kornizat e koshereve të bletëve, cilat janë një komponent kyç i



Linja moderne e prodhimit për korniza të koshereve në punishten e Genc Cakaj.

importet.

Çdo vit, Kosova importon rreth 500,000 korniza për kosheret e bletëve, përkundër faktit se ka mbi 7,500 bletarë që menaxhojnë më shumë se 200,000 koshere bletësh.

Duke kaluar nga importi në prodhim vendor, kjo nismë po krijon **vende të reja pune** dhe mundësi për punë të kualifikuara në zonat rurale, ndërkohë që po hap edhe rrugën drejt **tregjeve të eksportit**, veçanërisht në Shqipëri dhe Greqi, ku kërkesa për pajisje bletarie vazhdon të rritet.

Kjo iniciativë promovon përdorimin e drurit të cilësisë më të ulët nga Pronarët e Pyjeve Private (PPP) për prodhimin e kornizave të koshereve, duke i dhënë këtij materiali, i cili përndryshe ka vlerë të ulët, një përdorim produktiv në vend që të digjet si lëndë zjarri.



Genc Cakaj punon me pajisjen e re për prodhimin e kornizave të koshereve me cilësi të lartë

Në të njëjtën kohë, nisma inkurajon mbjelljen e drunjve me rritje të shpejtë të bagremit, të cilët ofrojnë një burim të qëndrueshëm druri duke mbështetur njëkohësisht biodiversitetin dhe duke kontribuar në prodhimin afatgjatë të biomasës.

Kjo punë është pjesë e përpjekjes më të gjerë të CNVP-së në kuadër të projektit SUNREED për të mbështetur pylltarinë e qëndrueshme, energjinë e rinovueshme dhe jetesën rurale në Kosovë.



Krijohet Fidanishtja e Parë për Prodhimin e Fidaneve të Drunjëve me Rritje të Shpejtë

Zgjidhje Lokale për Pylltari

Në vitin 2023, **Fidanishtja**, një biznes familjar në Dobrushë, Istog, bashkëpunoi me CNVP-në përmes projektit **SUNREED** për të lansuar **fidanishten e parë në Kosovë të fokusuar në speciet e drunjëve me rritje të shpejtë**. Ky është një hap i madh përpara për energjinë e rinovueshme lokale dhe pylltarinë e qëndrueshme.

Me mbi 20 vite përvojë në prodhimin e fidanëve frutorë si gështenjat dhe arrat, fidanishtja tani po kultivon **lastarë dhe fidane të plepit** – një lloj druri me rritje të shpejtë, ideale për biomasë drunore.

Këta drunjë ndihmojnë në zvogëlimin e varësisë nga materialet e importuara për mbjellje, në uljen e kostove në për fermerët dhe përmirësimin e shkallës së suksesit të plantacioneve të reja.



Kalema plepi të gatshme për mbjellje

Përveç përfitimeve mjedisore, fidanishtja tashmë ka prodhuar tashmë rreth 7,000 fidanë për fermerët lokalë të cilët do të përdoren për energji dhe industri,

duke krijuar në këtë proces edhe tre vende të reja pune në këtë proces.

Fidanishtja tashmë po krijon vende pune lokale, veçanërisht për të rinjtë dhe fermerët, në punë të përditshme, si mbjellja, shumimi, ujitja, kontrolli i dëmtuesve dhe mirëmbajtja.

Një ekspert hungarez i pylltarisë i cili ka bashkëpunuar me CNVP-në vizitoi fidanishten, vlerësoi rezultatet e para dhe inkurajoi ekipin që të zgjerojë prodhimin nga lastarët në fidane të plota.



Fidanishtja për prodhimin e fidaneve të plepit.

Kjo nismë mbështet furnizimin lokal me fidanë të plepit me cilësi të lartë dhe çmim të përballueshëm, krijon mundësi të reja të ardhurash për familjet rurale dhe rrit shkallën e mbijetesës së plantacioneve të reja. Ajo përbën një hap praktik drejt arritjes së objektivave të Kosovës për energji të rinovueshme dhe ripyllëzim.

Kjo fidanishte po e shndërron një traditë familjare në një zgjidhje praktike për veprim ndaj ndryshimeve klimatike, për pavarësi energjetike dhe zhvillim rural.




Lidhja Midis Kosovës dhe Suedisë për Pylltari të Qëndrueshme, Energji të Rinovueshme dhe Mbrojtje Mjedisore

Nga 3 deri më 7 qershor 2025, CNVP Kosova realizoi një vizitë studimore në Suedi për të forcuar bashkëpunimin me institucionet kryesore atje në fushën e pylltarisë, energjisë së rinovueshme, biodiversitetit dhe ekonomisë rrethore. Një fokus kyç ishte prezantimi i projektit kryesor të CNVP-së, SUNREED, dhe eksplorimi i mënyrave se si ai përputhet me strategjinë suedeze të tranzicionit të gjelbër.

Delegacioni zhvilloi takime të nivelit të lartë me universitete, institute kërkimore, agjenci qeveritare dhe organizata mjedisore, duke rezultuar në partneritete të reja dhe mundësi për veprim të përbashkët. Vizita synonte gjithashtu të mësonte nga përvoja e Suedisë në fusha si tregu vullnetar i karbonit, pylltaria private, Natura 2000 dhe menaxhimi i mbeturinave.

Partneritete Strategjike të Inicuar

CNVP vendosi bashkëpunim me disa institucione kyçe suedeze: **Universitetin e Uppsala-s**, për të eksploruar zgjidhjet e energjisë së rinovueshme për zhvillimin rural; **Institutin Suedez për Kërkime Mjedisore IVL**, me fokus në ekonominë qarkore dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike; **Skogforsk**, i cili shprehu interes të madh për bashkëpunim në pylltarinë e qëndrueshme; dhe **Zero Mission**, që do të mbështesë zhvillimin e një pilot projekti për tregun vullnetar të karbonit në Kosovë.



Takim me përfaqësues të Departamentit të Energjisë dhe Teknologjisë në Universitetin e Uppsala-s

Angazhim për Shkëmbim të Njohurive dhe Mbështetje

Partnerët suedezë, duke përfshirë **Agjencinë Suedeze të Pyjeve dhe Shokatën Suedeze për Ruajtjen e Natyrës (SSNC)**, u angazhuan për shkëmbim ekspertësh, mbështetje teknike dhe bashkë-zhvillim të propozimeve për financim nga BE-ja dhe burimet ndërkombëtare.



CNVP në Agjencinë Suedeze të Pyjeve

Zgjerimi i Angazhimit Rajonal dhe Evropian të CNVP-së

CNVP gjithashtu forcoi lidhjet e saj me rrjetet evropiane përmes bashkëpunimit të SSNC-së me **Byronë Evropiane të Mjedisit**, duke rritur vizibilitetin e Kosovës në procesin e vendimmarrjes për politikat mjedisore evropiane. Diskutimet u fokusuan edhe në mundësinë e përafrimit të Kosovës me kornizën e **Natura 2000**.

Mbështetje nga Ambasada e Kosovës në Stokholm

Ambasada e Kosovës në Stokholm luajti një rol kyç në mbështetjen e vizitës, duke lehtësuar lidhjet dhe promovuar iniciativat e CNVP-së në Suedi.

Hapat e Ardhshëm

CNVP do të punojë për të forcuar bashkëpunimin me institucionet suedeze, organizatat e shoqërisë civile dhe kompanitë private në fushat ku CNVP kontribuon, si menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, prodhimi i biomasës, bioenergjinë, Produktet Pyjore Jo-Drusore, Bimët Mjekësore dhe Aromatike, si dhe tregu vullnetar i karbonit. Vizita rikonfirmoi rolin e CNVP-së si lehtësues në promovimin e tregtisë, bashkëpunimit ekonomik dhe shkëmbimit të njohurive për iniciativa të gjelbra dhe të përshtatshme ndaj klimës.

“Për më shumë informacion mbi punën e CNVP Kosova dhe ndikimin e saj,” vizito

<http://www.cnvp-eu.org/eng/index.php>